



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 145, Datë 06.06.2022

MBI

RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “KURUM INTERNATIONAL” SH.A., ME NR. 372, SERIA F12/17 NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 106, DATË 20.07.2012, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “d”, nenit 5, pika 1, gërma “d”, neneve 13 dhe 16, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.06.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 771/2-1 prot., datë 06.06.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “KURUM INTERNATIONAL” sh.a., me Nr. 372, Seria F12/17 në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 106, datë 20.07.2012, i ndryshuar”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 91, datë 28.04.2022, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 372, Seria F12/17, të shoqërisë “KURUM INTERNATIONAL” sh.a. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje ERE me shkresën nr. 70/14 prot., datë 28.04.2022, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 16.05.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ndërsa me shkresën nr. 404/2 prot., datë 05.05.2022, ERE i është drejtuar shoqërisë me “Njoftim vendimi dhe kërkesë për plotësim dokumentacioni”.

- Shoqëria “KURUM INTERNATIONAL” sh.a. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 404/3 prot., datë 13.05.2022, ka paraqitur dokumentacionin e munguar.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për rinovimin e licencës së furnizimit të energjisë elektrike bazuar në Aneksin A, të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”*, e ndryshuar.
- Shoqëria “KURUM INTERNATIONAL” sh.a. është mbajtëse e licencës nr. 372, Seria F12/17, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike që prej datës 20.07.2012, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 106, i ndryshuar së fundi me vendimin 87, datë 07.06.2017 me afat vlefshmërie deri në datën 07.06.2022.
- Neni 16, pika 1, e *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”*, përcakton se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë.
Sa më sipër, shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj në datën 05.04.2022, pra brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1.
- Shoqëria “KURUM INTERNATIONAL” sh.a. ka kryer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.
- Në zbatim të përcaktimeve të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”*, e ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: Formatin dhe dokumentacionin për aplikim; Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; Dokumentacionin financiar dhe fiskal dhe çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike. Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë tërësisht dokumentacionin e aplikimit si më poshtë:
 - Formatin dhe dokumentacionin për aplikim - neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”.
 - Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor - neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”.
 - Dokumentacionin financiar dhe fiskal - neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”.
 - Dokumentacionin teknik për veprimtarinë furnizimit të energjisë elektrike - neni 9, pika 4.8, gërmat “a”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, “i”.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të rinovojë licencën nr. 372 Seria F12/17, të shoqërisë “KURUM INTERNATIONAL” sh.a., në veprimtarinë e furnizimit energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit nr. 106, datë 20.07.2012, i ndryshuar për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 08.06.2022.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI